



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:179885
Datë: 13.01.2025
Numri i dokumentit: 06701286

P.nr.380/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit A.A nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.808/2024, të datës 26.06.2024, jashtë seancës dhe sipas detyrës zyrtare me datë 13.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim me numër Nd.358/2024, e datës 27.11.2024, e lidhur në mes të pandehurit A.A dhe të dëmtuarit V.M.
- II. HUDHET poshtë aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.II.nr.808/2024, e datës 26.06.2024, dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit A.A nga fshati....., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës meqenëse i pandehuri dhe i dëmtuari kanë arritur marrëveshjen për ndërmjetësim.
- III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm, me datë 26.06.2024, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.808/2024, kundër të pandehurit A.A nga fshati....., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

Me datë 05.12.2024 pranë kësaj gjykate është caktuar dhe mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilën seancën i pandehuri i ka propozuar gjykatës që kjo çështje penale juridike të referohet në procedurën e ndërmjetësimit meqenëse për një gjë të tillë plotësohen kushtet ligjore, me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim dhe këtë çështje penale juridike e ka referuar në procedurën e ndërmjetësimit.

Me datë 27.12.2024 pranë zyrë për ndërmjetësimin pranë kësaj gjykate është marrëveshja për ndërmjetësim me numër Nd.nr.358/2024, sipas të cilës i pandehuri i ka kërkuar falje për veprimet e veta të dëmtuarit dhe dëmin e shkaktuar tek i njeiti duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla ndërsa i dëmtuari ka deklaruar se e pranon kërkim faljen nga i pandehuri, heq dorë nga ndjekja penale dhe kërkesa pasurore juridike.

Andaj gjykata duke u bazuar në të lartcekurat si dhe në bazë të nenit 357 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i KPP-së dhe nenit 2, 4, 8, 14, të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.380/2024, me datë 13.01.2025

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.